



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 308, datë 10.09.2020

PËR
VERIFIKIMIN E PLOTËSIMIT NGA KANDIDATI Z. {...} TË TRE KRITEREVE TË
KANDIDIMIT PËR NGRITJEN NË DETYRË, NË GJYKATËN E APELIT DURRËS
DHE NË GJYKATËN E APELIT TIRANË, PËR POZICIONET E LIRA NË FUSHËN E
TË DREJTËS CIVILE, TË SHPALLURA ME VENDIMET NR. 171, NR. 181 DHE NR.
182, DATË 28.05.2020, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR DHE VIJIMIN E
PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT PËR KRITERET E TJERA LIGJORE TË
KANDIDIMIT

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 8, në pikën 4, të nenit 47, në pikën 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, si dhe në pikën 9, të Vendimeve të tij nr. 171, nr. 181 dhe nr. 182, datë 28.05.2020, lidhur me hapjen e procedurave të ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Durrës dhe Gjykatës së Apelit Tiranë, për tre pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, pasi shqyrtoi materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatorja e saj, znj. Marçela Shehu,

VENDOSI:

1. Verifikimin e plotësisimit nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 171, nr. 181 dhe nr. 182 datë 28.05.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.
2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 171, nr. 181 dhe nr. 182 datë 28.05.2020.
3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR